



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
/KANCELARIJA PRESELDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e VI-të e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e mbajtur më 23 dhjetor 2024, në ora 10:00, në sallën e vogël të Komunës së Shtimes

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Nënkyryetari i Komunës, Faruk Beqa, komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, Berat Babaj (FSK), Skender Baftiu, (KBI), Skender Dauti, Vlora Hyseni (ZI), Ilaz Kadrijaj (QKMF), Shpresim Mahmuti (SHFMU), Reshat Gashi, Albert Ramadani(KLSP), Drita Bytyqi (PK), Bardhyl Rushiti (Drejtora e Sherbimeve Publike), Yllka Fejzullahu (Drejtoria e Arsimit), Arton Demiri, Muhamet Mehmeti (Zyrtar për të drejtat dhe integrim të komunitetit) dhe Albion Shabani.

Nënkyryetari i Komunës z. Beqa merr fjalën dhe falënderon të pranishmit që janë prezent në këtë mbledhje dhe prezanton pikat e rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.10 2024;**
- 2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;**
- 3. Parandalimi i dhunës në familje;**
- 4. Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike;**
- 5. Raport nga QKMF "Dr. Vezir Bajrami";**
- 6. Të ndryshme**

Faruk Beqa: Pikit e rendit të ditës për të cilat do të diskutojmë sot janë këto. Jeni të pajtimit? (anëtarët unanimisht votuan rendin e ditës).

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.10 2024;

Vazhdojmë pra më pikën e parë për Shqyrtimin e Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.10 2024, nese dikush doni të shton apo të hiqni diqka për këtë pikë. Konstatoj pra që aprovohet kjo pikë.

Pika e dytë është Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës, komandantin e kemi këtu dhe ja jap fjalën.

2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës

Haxhi Behluli: Ju përshëndes të gjithëve dhe shpresoj që jeni mirë. Në pika të shkurta do të mundohem t'ju informoj për çështje të sigurisë në komunën tonë. Edhe muaji nëntor ishte i qetë me disa probleme të vogla, por ajo që është më rëndësi gjatë këtij 11 muajt të këtij viti në përgjithësi situata e sigurisë është stabile.

Ajo që na bënë të ndihemi mirë është që gjatë këtyre 11 muajve, nuk kemi raste të vrasjeve në komunën tonë, e po ashtu as raste të aksidenteve me fatalitet, përveq rasteve që kanë qenë me lëndime. Me këtë rast falenderoj edhe qytetarët pasi vërehet një vetëdijësim nga ana e tyre sa u takon këtyre situatave. Dua të theksoj që edhe sa u takon veprave të ndryshme kemi rënje të theksuar, psh, lëndime trupore vitin e kaluar kishim 34, tanë i kemi 27 raste, të dhuna në familje për të cilën të gjithë së bashku kemi rritur nivelin e kujdesin, kemi një rritje të vogël të rasteve për shkak të rritjes së vetrëdijësimit për të cilin bëjmë thirrje gjithmonë, që kur ka raste të dhunës gjithmonë të deklarohen, nga 26 sa ishin vitin e kaluar, 31 i kemi tanë. Kemi edhe raste të tjera, por në përgjithësi gjendja është e mirë.

Shumë shkurt isha ndal edhe tek aksidentet e trafikut, të cilat edhe e përbëjnë sigurinë në trafik. I kemi 387 raste këtë vit, 385 ishin vitin e kaluar, dhe është një ulje e lehtë sa u takon këtyre aksidenteve, ndërsa është një ngritje e dyfishuar sa u takon gjobave që janë shqiptuar 2299 ishin vitin e kaluar, 4486 i kemi tanë.

Jemi duke vepruar me plane të ndryshme edhe për shkak që këtë muaj presim që të vijnë edhe mërgimtarë në këtë mënyrë rrisim edhe sigurinë më shumë.

Jemi duke trajtuar edhe raste të nxënësve nën moshëm 14 vjet, që kryesisht na ndodhin edhe nga përdorimi në mënyrë jo të mirë i rrjeteve sociale.

Faruk Beqa: Falemnderit komandant. Tani nëse ju kujtohet nga mbledhja e kaluar patëm marr si përgjegjësi që t'a trajtojmë çështjen e fëmijës që vazhdimisht po na shkakton probleme në shkollë. Personalisht e kam marr përsipër, kam biseduar dhe kam takuar drejtorin e QPS-së, drejtorin e shkollës. QPS, nga ana e saj kanë marrë masat që duhen marr, por sipas informatave, nxënësi

pengon edhe procesin arsimor e nga kjo ka edhe paknaqësi të prindërve. Masa që i është shqiptuar nga drejtoria e shkollës është, suspendimi i tij, por ai prap vazhdon me sjellje të njejtë të papërmirësueshme.

Mendoj që të gjithë së bashku, duke filluar nga QPS, shkolla, policia por edhe nga ne si KKSB, kësaj qështje duhet t'i bëjmë zgjidhje. Fëmijën në fjalë, as shkolla nuk ka të drejtë t'a përjashton por mendoj që psigologja duhet të dal me ndonjë rekomandim, që ky të trajtohet nga ndonjë psikiatër.

Drita Bytyqi: Ajo që e nxit në njëfar mënyrë është edhe nana e tij, mendoj që edhe ajo do një trajtim, pasi fëmiu në fjalë një hov e merr edhe nga nana e tij. Herë e fundit që e kemi intervistuar, ajo ka qenë shumë e papërshtatshme, përkundër gjithë akterëve që janë munduar të mirren me trajtimin e fëmiut, nana është shkaktari që të gjitha me një potez i hedh posht. Duhet me u trajtu nana së pari, që të arrihet diçka, sepse ne e dimë që fëmiu është nën moshë 14 vjeçare, pa përgjegjësi penale, por e merr at guximin dhe përkrahjen nga nana dhe tani s'ka të ndalur. Veprimet edhe nga ana e shkollës janë marr të gjitha edhe është suspenduar, por momentin që është kthyer prap ka vazhduar me avazin e vjetër dhe të njejtat veprime i ka bërë.

Yllka Fejzullahu: Edhe në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për këtë rast, dhe të gjithë e dimë që është shqetësuese sepse ka paraqitur mjaft probleme në shkollë. Mund të them që ndoshta është një ndër rastet më të rënda, por fatkeqësisht nuk është i vetmi, raste të tilla kemi nëpër shkolla, por jo të këtij niveli dhe përmasave që është nxënësi në fjalë, por raste të tilla realisht vijnë çdo ditë që bëjnë pengesa. Unë kërkoj që për raste të tilla të kemi bashkëpunim të gjithë së bashku për parandalimin e këtyre rasteve.

Haxhi Behluli: Mendoj që bashkëpunimi ynë nuk ka munguar dhe nuk do të mungon asnjëherë, por siç u cek edhe gjatë mbledhjes problemi qëndron edhe te prindërit e tij.

Bardhyll Rushiti: dua të jap një sygjerim apo këshill, që ne së bashku si institucione që jemi, të bëjmë organizime të ndryshme që të mundohemi t'i pranadalojmë këto dukuri negative që po ndodhin, që secilën shkollë të ketë nga një aktivitet dhe të bashkëbisedojmë edhe me prindëri.

Skender Dauti: Duhet patjetër që të kemi një raport nga mjeku adekuat e pastaj të mirren masat tjera.

Faruk Beqa: Jemi të vetëdijshëm që çdo herë kemi raste të tilla, por ne si institucione duhet t'a trajtojmë këtë çështje më me prioritet.

Tani mendoj që të kalojmë në pikën tjeter të rendit të ditës.

3. Parandalimi i dhunës në familje;

Faruk Beqa: U përmend këtu në raportin e policisë, që në krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje të numrit të rasteve në dhunë në familje, por gjithashtu e përmendëm që kjo vjen edhe si rezultat i ngritjes së vetëdijes për paraqitjen e këtyre rasteve.

Kisha hapur diskutimin dhe mendoj që për këtë pikë, më së mirë mund të na informon Drita.

Drita Bytyqi: Sa u takon rasteve të dhunës në familje, në stacionin tonë policor trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Përmes donacioneve të ndryshme, në stacion kemi edhe një dhomë mike me të gjitha kushtet. Sa u takon dhunës në familje kemi raste të ndryshme, por kryesisht është dhuna ndaj femrës. Trajtimi bëhet duke filluar nga vendi i ngjarjes, nga vendet e ngjarjes, intervistimin por edhe menyra e tjerë duke përfshirë të gjithë akterët e duhura për rastet.

Faruk Beqa: Për këto raste duhet një bashkëpunim i gjitha institucioneve, që të kemi një ulje të dhunës në familje.

Haxhi Behluli: Pajtohem plotësisht, duhet që të reflektojmë me ndonjë program se me ndonjë fushatë, që të bëjmë parandalim, sepse dhuna jo çdo herë ndodh mes bashkëshortëve, por edhe mbredha familjes, vëllau me vëllaun, me prindërit e raste të ndryshme.

Skender Baftiu: Ju falenderoj të gjithëve për këto informata që na jepni vazhdimisht. Duhet të kemi përgjegjësi që të japim kontribut që të gjithë në ndalimin e këtyre dukurive dhe vetëdijësimin e qytetarëve. Mund të them lirisht që ne si Këshill i Bashkësisë Islame, një prej temave që më së shumti e diskutojmë nëpër ligjerata të ndryshme që i mbajmë dhe ku dërgojmë mesazhe të qarta në xhami e sidomos gjatë ditës së xhuma, është dhe ka të bëjë më familjen. Edhe gjatë fushatës së ditëve të aktivizimit kundër dhunës së familjes në baza gjinore, janë mbajtur ligjerata kyresisht me gra, ku ishte një pjesëmarrje kogjo e madhe e në mesin e tyre kishte edhe asambleiste.

Një gjë duhet ta kemi të qartë, islami, feja jonë, në asnjë mënyrë nuk e promovon dhunën, përkundërazi e ndalon rreptësisht dhunën ndaj çdo kujt, e sidomos dhunën në familje.

Kemi thënjen e profetit tonë, që e kemi obligim t'a përbajmë. "Më i miri prej jush është ai që kujdeset dhe sjellët mirë me familjen e tij", e kjo është shumë me rëndësi, sepse kjo është feja islame. Për këtë jemi të gatshëm, që për çdo organizim që bëhet, jemi të gatshëm të jepam kontributin tonë në ndalimin e dhunës në familje.

Dua të them edhe diçka, për pikën e katërt, edhe pse nuk jemi ende aty, por për shkak të kohës së drekës, më duhet të largohem. Ne e kuptojmë që festa e vitit të ri e ka atë atmosferën e vet dhe njerëzit mundohen të festojnë, por sa i përket mjeteve pirotektive, do të kërkoj nga të gjithë imamët e komunës tonë, që këtë të premte të përqojnë një mesazh që mos të përdoren mjetet piroteknike për shkak të shpenzimeve të kota dhe për shkak të rrezikimit të sigurisë. Unë përsonealisht nuk e di, se ku e gjejnë njërit që në këtë mënyrë djegin shumë të mëdha parash, shumë më mirë do të ishte sikur ato para t'u dedikoheshin njerëzve në nevojë. Ju falenderoj të gjithëve dhe mirupafshim në mbledhjet e ardhshme.

Albert Ramadani: Plani i KLSP-së, gjatë vitit që vjen pra 2025 do të jetë shumë më dinamik. Sa i takon rasteve të dhunës në familje, nga OSCE do të kemi një mbështetje edhe më të madhe por do të kemi edhe një ndikim pozitiv, pra do të kemi mekanizëm të ri.

Muhamed Mehmeti: Dua t'ju falenderoj të gjithëve, që bashkarisht bëni një punë shumë të mirë. Dashta të pyes përfaqësuesit e policisë, se a kemi raste të dhunës në familje nga komuniteti dhe a keni patur ndërhyrje.

Drita Byqyqi: Po kemi pasur raste të dhunës në familje edhe nga komunitetet. Janë trajtuar të gjitha sikur rastet e tjera që i trajtojmë pa kurfar dallimi.

Arton Demiri: Une vij nga komuniteti rom dhe sa i takon komunitetit tonë jemi katër shtëpi. Une i falenderoj të gjitha institucionet dhe dua t'ju njoftoj që për fat të mirë nuk kemi ndonjë problem

Faruk Beqa: Me këtë konstatoj që edhe pika e tretë e drendit të ditës përfundoj, kalojm pra në pikën e radhës.

4.Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike;

Faruk Beqa: E di që drejtori kohëve të fundit ka marrë masa, por për më shumë fjalën ja kaloj drejtorit Bardhyl Rushiti.

Bardhyl Rushiti: Kemi një urdhëresë këtyre ditëve, që ka dal nga zyra e kryetarit dhe e cila është bazuar një njoftimin e Ministrisë së Punëve të Mbrenshme, në të cilën ceket që lejohet shitja nga data 19 dhjetor deri më 31 dhjetor, ndërsa përdorimi i tyre është nga 26 dhjetori deri më 31 janar. Jemi duke u munduar që t'i përbahemi kësaj urdhërese edhe pse është paksa problematike, por do të ecim tutje dhe shpresoj që edhe me ndihmën e policisë do t'ia dalim.

Haxhi Behluli: Kam njoftuar njësitë përkatëse edhe përmes shkresës që u'a kam përcjellur dhe angazhimi tanimë veqse është shtuar dhe do të jenë në bashkëpunim me inspektorët.

Faruk Beqa: Edhe këtë pikë e konsideroj të mbyllur dhe tani kalojmë në pikën tjetër.

5.Raport nga QKMF “Dr.Vezir Bajrami”;

Faruk Beqa: Këtu të pranishëm kemi drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Dr.Ilaj Kadrijaj. Drejtor fjal është për ty dhe të falenmderoj edhe njëherë për pranin tëndë sot këtu.

Ilaz Kadrijaj: Përshëndetje për të gjithë juve anëtarë. Ne si QKMF, kemi një mision dhe një vizion. Misioni i QKMF ka për qëllim ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore të sigurta, të ndërtuara mbi parimin e konceptit të mjekësisë familjare, të drejtura nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësive. QKMF është përkushtuar që në vazhdimësi të përmirësoj cilësinë dhe shërbimet e ofruara. Ndërsa vizioni i QKMF-së është shëndeti më i mirë i mundshëm i popullatës së Komunës së Shtimes përmes jetësimit të plotë të konceptit të mjekësisë familjare.

Gjatë vitit 2024 për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024 në Qendrën e Mjekësisë Familjare “Dr.Vezir Bajrami” në Shtime dhe në QMF-në Muzeqine, QMF Petrovë, QMF në Pjetërshtice dhe

QMF-në në Godanc, janë kryer gjithësej 138649 vizita mjekësore dhe 299058 shërbime shëndetësore.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar edhe aktivitete të ndryshme shëndetësore duke përfshirë këtu edhe aktivitete nëpër shkolla të komunës tonë.

6.Të ndryshme

Faruk Beqa: Falemnderit drejtës për këtë raport dhe informata. Nëse nuk keni diçka për të shtuar, konsideroj që këtë mbledhje ta mbyllim këtu, për të vazhduar me mbledhjet e radhës vitin që vjen. Mirupafshim dhe ju falenderoj për kontributin e juaj që keni dhënë gjatë këtij viti.

Mbledhja përfundoi në ora : 11:40

Procesmbajtëse:

Vlora Hyseni



LISTA E PJESËMARRËSVE NË MBLEDHJEN E VI (GJASHTË) TË KKSBB-së

Shtime, 23 dhjetor 2024 (e hënë)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	DILAZ KADRIJAS	QAKMF-SHETIME	<u>d. Vlaz</u>
2	Shpresim Mehmeti	ShFMV	<u>JH</u>
3	Rexhat Cukri	ZKO-ZDGJ	<u>fuz</u>
4	SKENDER BAFIU	Kryetari - K.B.i	<u>Bafiu</u>
5	ALBERT RAMADANI	KLSP-SHETIME	<u>Ramadani</u>
6	FATIK BODA	NEKRYETOR - Komuniteti	<u>F</u>
7	BERAT BABAI	FSK	<u>Berat</u>
8	DEITA BYTSQI	POLICIA E KOSOVËS	<u>D Bytqi</u>
9	Bardhyl Rushi	Prejtor	<u>Bardhyl R.</u>
10	Skënder Dauti	uillagës i ZYSH	<u>Dauti</u>
11	Yllka Fcizullahu	DKA	<u>Yllka</u>
12	Vlora Tepani	Zyra për Informim	<u>Tepani</u>
13	Albion Shabani	Zyra për informim	<u>ASh</u>
14	Haxhi Beshluli	KOMANDANTI STACIONIT	<u>H. Beshluli</u>
15	Artur Denari	Rom	<u>Denari</u>
16	Muhamed Mehmed	Zyrtar për të drejtat dhe Integrimit të komunitetit	<u>M. Mehmed</u>
17			